



VENDIM

Nr.132 Datë 31.10.2015

PËR

FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT TË ZYRËS SË KOORDINUAR TË ANKANDEVE PËR EVROPËN JUGLINDORE (SEE CAO) VERSIONI 1.3.

Në mbështetje të neneve 16 dhe 65 pika 1 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike, nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, date 18.03.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2015, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur dhe të rënë dakort nga (SEE CAO) dhe TSO-të aksionerë të saj, të Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandëve për Europën Juglindore (SEE CAO) dhe relacionin përkatës, për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandëve për Europën Juglindore (SEE CAO).

Konstatohet se:

- Sekretariati i Energjisë (Vjene, Austri) datë 22.09.2015 dhe mbledhja 11-të e ECBR-së mbajtur me datë 09.07.2009, rekomandon që rregullatorët Kombëtarë t’ a miratojnë këtë rregullore.
- Rregullorja është e hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores (KE) 714/2009 të Parlamentit Evropian.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e rregullave të ankandit të zyrës së koordinuar të ankandeve për Evropën Juglindore **SEE CAO** (bashkëlidhur draft “Rregullat e Ankandit Versionin 1.3 në gjuhën origjinale Angleze).
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë personat e interesuar për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit AHMETI